



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4269 prot.

Himarë, më 12.06 . 2026

VENDIM
Nr. 28 , Datë 04/06 /2026

PËR
NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.15, DATË 28/04/2026 “PËR MIRATIMIN E
PLANIT TË PUNËS,
PËR MENAXHIMIN E SUKSESSHËM TE SEZONIT TURISTIK 2026 DHE
PLANIT TË VEPRIMIT PËRKATËS“

Baza ligjore:

- Ligji nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”.
- Ligji nr.107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 93/2015, “Për Turizmin”.
- Ligji nr.9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave Vendore”, i ndryshuar.
- Ligji nr.8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 9251, datë 08.07.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 89/2022 “Për policinë bashkiake”.
- VKM nr. 1096 datë 28.12.2015 “Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike”.
- VKM nr. 462, datë 09.07.2014, “Për miratimin e rregullores “Për regjistrimin e mjeteve lundruese në Republikën e Shqipërisë”.
- VKM nr.649, datë 16.10.2024, “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit” (i përditësuar).
- VKB nr.57, datë 26.11.2025 Himarë, “Për disa ndryshime në “Paketën fiskale të vitit 202”, ndryshuar me VKB nr. 54 datë 25.11.2021, ndryshuar me VKB nr. 34, datë 03.12.2024”.
- Ligji nr.9774, datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”.
- Udhëzimi Nr.2 datë 15.11.2023 “Për nivelin kufi të zhurmës për një mjedis të dhënë dhe për fushën e veprimtarive ekonomike shoqërore”.
- Ligji nr.8094, datë 21.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”.
- Ligji nr.9010, datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.798, datë 29.09.2010 “Për miratimin e rregullores “Për administrimin e mbetjeve spitalore”.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.228, datë 27.05.1992 “Për ruajtjen e mjediseve urbane nga ndotjet dhe dëmtimet”.
- Vendimi i Këshillit të Bashkisë së Himarë nr.4, datë 31.01.2020 “Për vendosjen e gjobave për shkeljet e kryera”.
- Vendimi i Këshillit të Bashkisë së Himarë nr. , datë . .20 “Për rregullimin dhe administrimin e mbetjeve urbane dhe pastrimin të qytetit”.
- Vendimi i Këshillit Bashkiak Himarë nr.64 datë 22.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të bashkisë për vitin 2026”.
- Vendimi i Këshillit Bashkiak Himarë nr.34, datë 09.07.2025 “Për miratimin e kahut të lëvizjes, orarit të lëvizjes dhe kufizimit të qarkullimit në disa akse të brendshme të mjeteve automobilistike në qytetin e Himarës”.
- Vendimi i Këshillit Bashkiak Himarë nr.15, datë 28/04/2026 “Për miratimin e planit të punës për menaxhimin e sukseshëm të sezonit turistik 2026 dhe planit të veprimit përkatës”.

Me qëllim sigurimin e një menaxhimi të suksesshëm dhe të qëndrueshëm të sezonit turistik 2026 në Bashkinë Himarë, duke përmirësuar shërbimet publike dhe infrastrukturën si dhe me synim rritjen e cilësisë së përvojës për turistët dhe banorët, si dhe koordinimin efektiv të institucioneve përgjegjëse. Me propozimin e Kryetarit të Bashkisë Himarë, Këshilli Bashkiak Himarë në mbledhjen e datës 04.06.2026, miratoi me 15 (pesëmbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) kundër, 2 (dy) abstenim dhe si më poshtë:

VENDOSI:

1. Miratimin e një shtese në vendimin e Këshillit Bashkiak Himarë nr.15, datë 28/04/2026 “Për miratimin e planit të punës për menaxhimin e sukseshëm të sezonit turistik 2026 dhe planit të veprimit përkatës”, për hyrje-daljet e mjeteve lundruese.
2. Miratimin e hartave shtesë bashkëlidhur këtij vendimi të vendbazimeve dhe korridoreve të lëvizjes të mjeteve lundruese tyre
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Himarë, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë dhe administrata e Bashkisë Himarë.

Ky vendim hyn në fuqi sipas Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 55, pika 6.

KRYETARI

Dhimitër Kapaj

